



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –DRAGASH
OPSTINE DRAGAS
MUNICIPALITY OF DRAGAS



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillim Rural
Direktoria za Poljoprivredu, Sumarstvo, Inspekciju, Turizam i Ruralni Razvoj

09.Nr. 320/01-20785/10

Dt. 11.11.2020

Dragash

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillim Rural bazuar në vendimin e kyetarit të komunës me nr.02Nr.320/1-20458 të datës 27.10.2020, në bazë të kërkesës së fermerëve të datës 02/11/2020 me Nr. protokolit 09/320/2-20965, në bazë të kërkesës së bletarëve të datës 06.11.2020 me nr.protokolit 09/320/1-21480 si dhe duke u bazuar në Rregullorën komunale nr. 01Nr.060/01-31587/1 të datës 24.12.2019 për kushtet, kriterët dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve :

THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohën të gjithë fermerët e komunës së Dragashit, të cilët posedojnë lopë qumështore, kafshë të imëta (dele dhe dhi), fermerët që posedojnë pula dhe flanza vojse si dhe bletarët se mund të aplikojnë për **subvencione në ushqime - pagesa përmes subvencioneve** nga ana e komunës.

Qëllimi

Qëllimi i kësaj thirrje është që ti ndihmohet fermerëve të regjistruar në Komunën tonë, që të tejkalojn problemët e shkaktuara nga pandemia Covid19 si dhe rimekëmbjen ekonomike.

Duke e parë situatën ekonomike të shkaktuar nga pandemia, fermerët e komunës sonë janë ballafaquar me probleme të natyrave të ndryshme si: pengesa në krijimin e ushqimeve të mjaftueshme për kafshë, problemet dhe pengesa të krijuara në shitjen e produkteve blegtorale si mishi, qumështi dhe pruduktet e qumështit, etj.

Komuna e Dragashit duke u bazuar në problemët e shkaktuara nga pandemia dhe duke u bazuar në kërkesat e vazhdueshme të fermerëve ka ndarë një fond për mbështetje dhe subvencionim të ushqimeve për kafshë në tejkalimin e kësaj situate të pafavorizuar për fermerët.

Shuma e subvencionit : 200,495.06 €

Kohëzgjatja e aplikimit 12-24 / Nëntor / 2020

Objektivat e thirrjesë

- Zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit
- Rritja e të hyrave në fermë
- Përmirsimi i konkurshmerisë
- Rritja e redimentit dhe cilsis së prodhimit

Kushtet për aplikim:

- Të jetë fermer i regjistruar në Komunën e Dragashit (Numrin e Nif-it)
- Numri i kafshëve (vërtetohet me kopjën e vërtetimit të lëshuar AUV-se si dhe formularin e aplikimit për subvencione të MBPZHR për vitin 2020).
- Kafshët duhet të jenë të matriculuara dhe regjistruar në Sistemin e Identifikimit dhe të Regjistrimit të Kafshëve në AUV.

Kjo skemë e subvencioneve do të mbështetë këto veprimtari:

-Përkrahje në blegtori :

1. Fermerët që mbarështojnë gjedhe qumështore
2. Fermerët që mbarështojnë dele për mbarshmëri (dele qumështore)
3. Fermerët që mbarështojnë dhi për mbarshmëri (dhi qumështore)
4. Fermerët që mbarështojnë pula vojse dhe flanza vojse në të gjitha fazat e prodhimit të aktive të vezëve;
5. Bletarët që posedojnë mbi 30 koshere me bletë

Kriterët që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

Fermerët që :

- Mbarështojnë së paku 5 krerë gjedhe qumështore e më shumë
- Mbarështojnë së paku 30 krerë dele për mbarshmëri e më shumë,
- Mbarështojnë së paku 20 krerë dhi e më shumë
- Mbarështojnë së paku 500 pula vojse e më shumë
- Mbarështojnë së paku 200 flanza vojse e më shumë
- Mbarështojnë së paku 30 koshere me bletë

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë fermerët e komunës së Dragashit të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara nga organet kompetente

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Fletëaplikacioni (merrët në zyrën pritëse komunale dhe plotësohet),
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës,
- Konfirmimi i llogarisë bankare (llogaria bankare të jetë aktive);
- Vërtetimin dhe regjistrin e lëshuar nga AUV-kopje (për lopë, dele dhe dhi qumështore) duke u bazuar në të dhënat e Sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të Kafshëve në AUV
- Për pulat dhe flanzat vojse Dëshmi nga veterinarin për aplikimin e programit të vaksinimit të tufës së pulave vojse,
- Për bletët kopja e vërtetimit të numrit të bletëve të lëshuar nga drejtoria për bujqësi
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë
- Fatura e rregullt për ushqime të koncentruara (për bletët ushqime dhe medikamente për trajtim) të lëshuar brenda datës së publikimit të thirrjesë (vlera e faturës llogaritet në bazë të numrit të krerëve shumëzuar me vlerën e caktuar për krerë ndërsa për bletët numri i bletëve 30-60 koshere fatura duhet të llogaritet në vlerë 140 euro ndërsa mbi 60 koshere 220 euro).

Dokumentet duhet të protokollohen në zyrën e pranimit drejtuar Drejtoratit për bujqësi.

Mënyra e subvencionimit

Subvencionimi do të bëhet për krerë: për qedhe qumështore në vlerë prej **60** euro, për dele dhe dhi qumështore në vlerë prej **6** euro, për pula dhe fllanza vojse në vlerë prej **0.30** euro, për bletët nga **30-60 koshere në vlerë 140 euro** ndërsa mbi **60 koshere në vlerë 220 euro**. Fermerët duhet të paisenë më faturë të rregulltë për blerjen e ushqimit të koncentruar apo drithërave për bletët ushqime dhe medikamente për trajtim sipas vlerës së llogaritur për krerë të aplikimit duke u bazuar në aplikacionin për pagesa direkte të MBPZHR për vitin 2020.

Vërejtje:

Përkrahën fermerët që kanë deklaruar numrin e krerëve dhe kanë aplikuar për pagesa direkte të MBPZHR për vitin 2020.

Vlerësimi dhe kontrolli

Vlerësimi dhe kontrolli do të bëhet nga komisioni komunal.

Drejtori
Fejsal Halilović

